



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit
P-009
Prishtinë, më 11 mars 2008, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 11 MARS 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati, dhe Eqrem Kryeziu, kurse munguan Xhavit Haliti dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha, Ardian Gjini dhe Ibrahim Makolli, kurse mungoi Bojan Stojanoviq .

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI-a: Rinor Beka dhe Ian Perkins, dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i vendimit për shpalljen e konkursit për Himnin e Republikës së Kosovës,
2. Shqyrtimi i parë i projektligjeve nga Propozimi i Ahtisarit.

1. Shqyrtimi i vendimit për shpalljen e konkursit për Himnin e Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në takimin me Kryetarin e Komisionit për Flamur, Stemë dhe Himnin, i ngarkuari nga Grupi i Unitetit, z. Hajredin Kuçi, i ka dhënë shpjegimet sa u përket dilemave që u shtruan nga Kryesia në mbledhjen e 10 marsit 2008 lidhur me tekstin e konkursit.

Ai tha se Komisioni për zgjedhjen e himnit, është në përbërje të partive politike, të pozitës dhe opozitës të Presidencës, kurse Juria do të ketë edhe dy anëtarë të sferës akademike të muzikës, të cilët nuk marrin pjesë në konkurs.

Pagesa për fituesin e konkursit do të bëhet nga Fondi për Festimet, që është i caktuar nga Qeveria.

Kryesia, pas diskutimeve të të gjithë anëtarëve të saj, mori këtë

V E N D I M

1. Shpallet konkursi për Himnin e Republikës së Kosoves, sipas kriterëve të propozuara nga Komisioni i Konkursit.
2. Afati i konkursit zgjatë njëzet ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.
3. Ngarkohet Administrata e Kuvendit t'i marrë veprimet procedurale për shpalljen e konkursit.

2. Shqyrtimi i parë i projektligjeve nga Propozimi i Ahtisarit

Kryetari i informoi të pranishmit se Qeveria ia ka paraqitur Kuvendit pjesën e dytë të projektligjeve nga Pakoja e Ahtisarit, si në vijim :

1. Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës,
2. Projektligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

3. Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
4. Projektligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës,
5. Projektligji për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
6. Projektligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të vitit 2008,
7. Projektligji për financat e pushtetit lokal,
8. Projektligji për Aviacionin Civil,
9. Projektligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës,
10. Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Kryesia, në bazë të Vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008, vendosi që seanca e ardhshme për shqyrtimin, në parim, të pjesës së dytë të projektligjeve nga Pakoja e Ahtisarit të mbahet më 12 mars 2008 në orën 14:00.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 10 : 45.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale